



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratorja: Dr. Fidelma Donlon

Data: 15 prill 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë të Pjetër Shalës dhe çështjet
lidhur me të**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen (Jean-Louis
Gilissen)

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 20 dhe 39(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 8(3)(a), 87(6), 92(1) dhe 96 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara ("Rregullorja"), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shkurt 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") paraqiti për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* së bashku me materialet provuese në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.²

2. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi "Vendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Pjetër Shalës" ("Vendimi i konfirmimit"),³ "Fletarrestim për z. Pjetër Shala"⁴ dhe "Urdhër për transferimin në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara".⁵

3. Më 19 qershor 2020, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar ("Aktakuza e konfirmuar"),⁶ me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁷

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i aktakuzës për konfirmim dhe kërkesave lidhur me të*, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Pjetër Shalës* ("Vendimi i konfirmimit"), 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shalan*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00008/A02, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për transferimin në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i aktakuzës së konfirmuar*, 19 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁷ Vendimi i konfirmimit, paragrafi 140(c).

4. Më 16 mars 2021, Pjetër Shala ("z. Shala" apo "i akuzuari") u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës ("Belgjikë") nga policia belge në prani të përfaqësuesve të ZPS-së.⁸

5. Më 31 mars 2021, ZPS-ja dorëzoi "Parashtrim të versionit me më pak redakte dhe i versionit të redaktuar publik të aktakuzës së konfirmuar dhe kërkesave lidhur me të".⁹

6. Më 15 prill 2021, pas përfundimit të procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHSK") në Hagë, Holandë.¹⁰

7. Më 15 prill 2021, në pritje të përfundimit të vlerësimit të varfërisë, Administratorja caktoi me kusht Zhan-Lui Zhilisen ("z. Zhilisen") si mbrojtës të z. Shala, në përputhje me pjesën 14(3) të Direktivës për Mbrojtësit dhe rregullën 11 të Rregullores së Ndihmës Juridike.¹¹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. PARAQITJA E PARË

8. Sipas nenit 39(4) të Ligjit, në zbatim të urdhërarrestit ose fletarrestimit të lëshuar nga Dhomat e Specializuara, personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuza merret

⁸ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 16 mars 2021 rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00016, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i versionit me më pak redakte dhe i versionit të redaktuar publik të aktakuzës së konfirmuar dhe kërkesave lidhur me të*, 31 mars 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për pranimin e Pjetës Shalës në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për caktimin me kusht të mbrojtësit*, 15 prill 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, paragrafi 2.

¹¹ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për pranimin e Pjetës Shalës në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për caktimin me kusht të mbrojtësit*, 15 prill 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, paragrafi 3.

në ndalim, informohet menjëherë për akuzat kundër tij ose saj dhe transferohet në Dhomat e Specializuara.

9. Në bazë të rregullave 87(6) dhe 92(1) të Rregullores, i akuzuari nxirret para Gjykatësit të Procedurës Paraprake pa vonesë të papërligjur për paraqitjen e tij apo të saj të parë.

10. Në bazë të neneve 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, seancat, duke përfshirë seancën e paraqitjes së parë të të akuzuarit, janë publike, përveçse kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos ndryshe në përputhje me Rregulloren.

B. GJUHËT E PUNËS

11. Në bazë të nenit 20 të Ligjit, gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze dhe gjatë çdo procedure paneli mund të vendosë për gjuhën e punës gjatë procedurës, sipas nevojës dhe duke i respektuar në plotësi të drejtat e të akuzuarit, siç parashihen në bazë të nenit 21 të Ligjit.

12. Sipas rregullës 8(3)(a) të Rregullores, në varësi të nenit 20 të Ligjit, në fazën më të hershme të mundshme, pasi t'i ketë dëgjuar palët, dhe kur është e përshtatshme mbrojtësin e viktimave, paneli vendos se cila gjuhë ose gjuhë të punës do të përdoren gjatë procesit.

C. KONFERENCAT MBI ECURINË E ÇËSHTJES

13. Në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencën mbi ecurinë e çështjes sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit për: (i) organizimin e shkëmbimeve mes palëve, dhe kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej

palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore që palëve, dhe kur është e zbatueshme mbrojtësit të viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

14. Në përputhje me rregullën 96(2) të Rregullores, konferenca për ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit, me pjesëmarrjen e mbrojtësit të tij apo të saj nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit, me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me praninë e mbrojtësit ose me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës.

III. DISKUTIM

A. PARAQITJA E PARË

15. Duke marrë parasysh se arrestimi i z. Shala dhe transferimi i tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara u kryen përkatësisht më 16 mars 2021 dhe më 15 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme të caktojë një seancë për paraqitjen e parë të të akuzuarit sa më shpejt që të jetë e realizueshme, duke mbajtur parasysh kufizimet prej KOVID-19, me qëllim që të respektohen të drejtat e tij të parapara në Ligj.

16. Gjithashtu, duke marrë shënim se seancat mund të bëhen publike edhe jashtë sallës së gjyqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon bërjen e fotografimeve në fillim të seancës së paraqitjes së parë.

B. GJUHËT E PUNËS

17. Duke marrë parasysh arrestimin dhe transferimin e z. Shala dhe në përputhje me të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 21 të Ligjit, është e domosdoshme të caktohet gjuha e punës e këtij procesi, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i drejtë, efikas dhe i shpejtë

i tij. Për këtë qëllim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron palët që të paraqesin vërejtjet e tyre gojarisht, lidhur me gjuhën e punës së procesit gjatë paraqitjes së parë.

18. Gjykatësi i Procedurës paraprake vëren se, deri më tani, gjuha e punës së procesit ka qenë gjuha angleze, sepse të gjitha parashtrimet e protokolluara të paraqitura nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Administratorja si dhe të gjitha vendimet dhe urdhrat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake janë lëshuar në gjuhën angleze. Rrjedhimisht, pasi të ketë marrë vërejtjet e palëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vendosë nëse ka arsye bindëse për të hequr dorë nga përdorimi i gjuhës angleze si gjuhë pune.

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se vendimi mbi gjuhën e punës së procesit nuk do të ketë ndikim mbi gjuhën dhe/ose përkthimin e provave dhe dokumentacionit të nevojshëm në dobi të të akuzuarit.¹²

C. DATA E KONFERENCËS PËR ECURINË E ÇËSHTJES

20. Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton palët që të paraqesin parashtrimet e tyre gjatë paraqitjes së parë, për të deklaruar disponueshmërinë e tyre për të marrë pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes të premtën, më 23 prill 2021. Mbrojtja ftohet që të bëjë të qartë në parashtrimin e vet nëse mbrojtësi dhe/ose z. Shala është i gatshëm të marrë pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes duke qenë fizikisht i pranishëm apo përmes videokonferencës, siç përcakton rregulla 96(2) e Rregullores.

D. VERSIONI I REDAKTUAR I VENDIMIT TË KONFIRMIMIT

21. Që vendimi i konfirmimit të vihet në dispozicion të të akuzuarit dhe të publikut sa më shpejt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Zyrën e Prokurorit të

¹² Nenet 21(4)(a) dhe 39(5) të Ligjit; rregullat 86(8), 87(1), 92(2)(b) dhe 102(1) të Rregullores.

Specializuar që të dorëzojë parashtrime me shkrim nëse ka, deri të hënën, më 26 prill 2021, në lidhje me redaktimet e propozuara që duhet të zbatohen në atë vendim.

IV. VENDIM

22. Për arsyet a lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **VENDOS** të mbajë seancën e paraqitjes së parë të z. Shala të **hënën, 19 prill 2021, në orën 15:00;**
- b) **AUTORIZON** Administratoren të organizojë në fillim të seancës së paraqitjes së parë bërjen e fotografive për një minutë e gjysmë;
- c) **URDHËRON** palët që në seancën e paraqitjes së parë të paraqesin gojarisht parashtrimet e tyre lidhur me gjuhën e punës që do të përdoret gjatë procesit;
- d) **FTON** palët që në seancën e paraqitjes së parë të paraqesin gojarisht parashtrimet e tyre siç përcaktohet në paragrafin 20 më sipër, lidhur me disponueshmërinë e tyre për një konferencë mbi ecurinë e çështjes të premten, 23 prill 2021; dhe
- e) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë deri të hënën, 26 prill 2021, ndaras parashtrime me shkrim rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, nëse ka, në lidhje me redaktimet e propozuara që duhet t'i bëhen vendimit të konfirmimit, me qëllim që ai t'u vihet në dispozicion Mbrojtjes dhe publikut.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 15 prill 2021
Në Hagë, Holandë.